



**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji**

**Duke u bazuar në:**

- Nenin 8 paragrafi 1 nënparagrafi 1.6, nenin 14 paragrafi 2 nënparagrafi 1.7 dhe nenin 25 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L-185);
- Nenin 4, 5 dhe 13 të Rregullës për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Kapaciteteve të reja; dhe
- Aplikacionin për Autorizim për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga uji, në Lumin Lepenc, HC Lepenci 3, me kapacitet të instaluar prej 8.5 MW, në lokacionin “Sllatinë”, komuna e Kaçanikut, të datës 03.06.2013 të ndërmarrjes “Hidroenergji” SH.P.K., me adresë “Dëshmorët e Kombit”, p.n. –Komuna Ferizaj, Republika e Kosovës,

**në seancën e mbajtur me datë 06 shtator 2013 nxori këtë:**

**V E N D I M**

**Mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar**

- I. Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) konstaton se ndërmarrja “Hidroenergji” SH.P.K., ka dëshmuar përshtatshmërinë për zhvillimin e projektit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga uji, në Lumin Lepenc, HC Lepenci 3, me kapacitet të instaluar prej 8.5 MW, në lokacionin “Sllatinë”, komuna e Kaçanikut.
- II. Aplikantit “Hidroenergji” SH.P.K., mund t’i lëshohet AUTORIZIMI për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese, pas përmbushjes së kërkesave që dalin nga Nenet 14 dhe 15 të Rregullës për Procedurën e Autorizimit dhe kërkesave tjera të legjislacionit tjetër të aplikueshëm lidhur me ndërtimin e stabilimenteve të reja gjeneruese.
- III. Vendimi mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar nuk i jep të drejtë bartësit që të fillojë ndërtimin e stabilimenteve të reja gjeneruese para se t’i plotësojë të gjitha kushtet dhe kërkesat e përcaktuara në pikën II. të këtij Vendimi.
- IV. Vendimi mbi njoftimin për autorizimin preliminar, i lëshohet ndërmarrjes “Hidroenergji” SH.P.K., për dy (2) vite, dhe obligohet që brenda kësaj periudhe të bëjë kërkesë me shkrim duke kërkuar që ti lëshohet Autorizimi për ndërtim të stabilimenteve të reja gjenerues nga Uji.

**A r s y e t i m**

- o ZRRE me datë 03.06.2013 nga ndërmarrja “Hidroenergji” SH.P.K., ka pranuar aplikacionin për marrjen e autorizimit për ndërtim të kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga uji, në Lumin Lepenc, HC Lepenci 3, me kapacitet të instaluar prej 8.5 MW, në lokacionin “Sllatinë”, komuna e Kaçanikut.



- ZRRE, pas vlerësimit të dëshmive të bashkangjitura aplikacionit dhe pranimet të dëshmive tjera plotësuese, të kërkuara nga ZRRE, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- V. Vendim nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- VI. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimet të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

#### **Bordi i ZRRE-së**

---

Enver Halimi, kryesues

---

Përparim Kabashi, anëtar

---

Blerim Koci, anëtar

---

Merita Kostari, anëtare

---

Krenar Bujupi, anëtar